

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm ,Divizioni Civil**, nga gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Lendita Pajaziti, në çështjen juridike të paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED] të cilin e përfaqëson me autorizim [REDACTED] kundër të paditurit [REDACTED] nga ish nga fshati [REDACTED] tani me adresë të panjohur të cilin e ka përfaqësuar përfaqësuesi i përkohshëm av. [REDACTED] nga Ferizaj, në çështjen juridike vërtetim pronësisë, pas seancën kryesore publike të mbajtur më 07.04.2016 në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit, mori këtë:

### AKTGJYKIM

**I APROVOHET** kërkesë padia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED] e paraqitur kundër të paditurit [REDACTED] nga ish nga fshati [REDACTED] tani me adresë të panjohur, **si e bazuar.**

**II VËRTETOHET** se paditësi [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna [REDACTED], është pronar i paluajtshmërive dhe atë në NK.nr.983-0, në sipërf. prej 529 m<sup>2</sup>, NK.nr.158-0 në sipërf.6853 m<sup>2</sup>, NK.nr.159-0 në sipërf.4506 m<sup>2</sup>, NK.nr.193-0 në sipërf. 9916 m<sup>2</sup>, NK.nr.194-0 në sipërf.396 m<sup>2</sup> të cilat ngastra gjendet në vendin e quajtur "Ivkove Njive" ZK. Dardani që evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.32 ZK Dardani.

**III OBLIGOHET** i padituri [REDACTED] që t'ia pranoj paditësit të drejtën e pronësisë, në paluajtshmëritë e blera dhe t'ia bartë në emrin e tij në afat prej 15 ditësh, në të kundërtën ky aktgjykim, paditësit do t'i shërbej si dëshmi tabulare për bartjen e pronësisë në librat kadastral të ZK. [REDACTED], pa prezencën e të paditurit.

**IV OBLIGOHET** paditësi që te paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 235 € ne afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhune.

## A r s y e t i m

Përfaqësuesi i paditësit me autorizim në fjalën e tij ka deklaruar se me anë të parashtresës të dorëzuar me dt.04.04.2016 ka bërë precizimin e kërkesë padisë në kuptim objektib sa i përket ngastrave kadastrale i cili precizim është bazuar në kontratën e lidhur me shkrim në mes paditësit dhe të paditurit si dhe në ekspertizën me shkrim të përpiluar nga ana e ekspertit të gjeodezisë, duke shtuar se paditësi përmes kontratës me shkrim të dt.31.07.1984, e cila është e nënshkruar nga palët ndërgjygsore në cilësi të kontraktuesve paditësi i ka blerë paluajtshmërin që janë objekt i kësaj kontrate dhe të njëjtën e ka përmbushur në tërësi dhe në të cilat ngastra është futur në posedim me mirëbesim nga ajo kohë në mënyrë të qet dhe i pa penguar nga askush me tepër se 20 vite.

Njëherit ka shtuar se me anë të kësaj kontrate vërtetohet koha e posedimit si dhe realizimi i çmimit të asaj kontrate, e cila është vërtetuar edhe me dëgjimin e dëshmitarëve, ku edhe ata deklaruan se paditësi ka blerë paluajtshmëritë nga i padituri, dhe ndaj të njëjtit i ka kryer obligimin kontraktues dhe atë pagesën e çmimit të shitblerjes në tërësi.

Kjo u vërtetuan edhe me daljen në vendin kontestues, duke shtuar se nga provat e administruara është vërtetuar se paditësi paluajtshmëritë që janë objekt i kërkesë padisë në bazë të kontratës i ka blerë nga i padituri duke kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesë padinë e pasitësit ta aprovon si të bazuar.

Nuk është deklaruar për shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesja përkohshme e te paditurit av. [REDAKTUAR] në fjalën e tij ka deklaruar se NK të cilat janë pjesë e kontratës me shkrim të lidhur në mes paditësit dhe të paditurit shihet se paditësi i ka blerë, ku dhe në pikën II të kësaj kontrate është përcaktuar edhe çmimi kontraktues ku sipas dëshmisë së dëshmitarit [REDAKTUAR] paditësi e ka paguar këtë çmime në tri rata brenda një viti dhe nga ajo kohë paditësi ka hyrë në posedim.

Me rastin e daljes në vendin e ngjarjes është vërtetuar se paditësi është në posedim dhe shfrytëzim të këtyre ngastrave.

I ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim meritor si dhe i ka kërkuar shpenzimet për një përfaqësim pasi që shpenzimet tjera paditësi i ka kryer.

Gjykata për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave sipas propozimit të palëve bëri administrimin e këtyre provave: U lexua padia e paditësit C.nr.257/09 dt.25.08.2009, Kontrata e lidhur më dt.31.07.1984 në mes [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] si shitës nga njëra anë dhe [REDAKTUAR] si blerës nga ana tjetër, e përpiluar tek avokati [REDAKTUAR], e pa vërtetuar në gjykatë, në gjuhën serbe dhe shqipe, Autorizimi i paditësit dhen av. [REDAKTUAR], Shkresa e përpiluar nga zyra komunale për komunitete e dt.02.10.2009, Autorizimi i paditësit dhënë të autorizuarit [REDAKTUAR], Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. 257/09 dt.11.11.2015, me të cilën të paditurit, i është caktuar përfaqësuesi i përkohshmen av [REDAKTUAR] ( shqip, serbisht dhe anglisht), Përgjigja në padi e paraqitur nga ana e përfaqësuesit të përkohshëm e dt.29.12.2015, Parashtrësia për precizimin e kërkesëpadisë e dt.04.04.2016, Ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë , përpiluar nga ana e ksprtit [REDAKTUAR] dt.19.02.2016.

Bazuar në provat e administruara, vlerësimin e tyre një nga një dhe në lidhmëri me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga provat e administruara, dëgjimi i dëshmitareve, ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë daljes së gjykatës në vendin kontestues, është vërtetuar fakti se paditësi dhe i padituri ka lidhur kontratë me shkrim të nënshkruar nga palët kontraktuese, por e pa vërtetuar në gjykatë për shitblerjen e paluajtshmerive dhe e njëjta është përmbushur ne tërësi dhe se paditësi të drejtën e pronësisë në këto ngastra e ka fituar paditësi në bazë të kësaj kontrate mbi shitblerjen e paluajtshmerisë para 32 viteve, dhe se nga koha e blerjes së paluajtshmerive me dt.31.07.1984 e deri më tani paditësi i mban në posedim të qetë dhe të pa penguar nga askush.

Gjykata ka gjetur se provat e administruara përputhen me gjendjen faktike të cilën gjykata e ka konstatuar me daljen në vend, me anë të ekspertit të gjeodezisë në parcelat kontestuese, ku ka vërtetuar se parcelat kontestuese dhe atë NK.nr.983-0, në sipërf. prej 529 m<sup>2</sup>, NK.nr.158-0 në sipërf.6853 m<sup>2</sup>, NK.nr.159-0 në sipërf.4506 m<sup>2</sup>, NK.nr.193-0 në sipërf. 9916 m<sup>2</sup>, NK.nr.194-0 në



sipërf.396 m<sup>2</sup> të cilat ngastra gjendet në vendin e quajtur "Ivkove Njive" ZK. Dardani që evidentohen në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.32 ZK Dardani, ngastrat kontestuese që janë objekt i këtij kontesti të cilat janë përshkruar hollësisht në procesverbalin e daljes së gjykatës në vendin kontestues si dhe është përshkruar hollësisht nga ana e ekspertit të gjeodezisë me përkufizime përkatëse.

Gjykata me dëgjimin e dëshmitarit [REDAKTUAR] është vërtetuar fakti se i njëjti ka qenë edhe dëshmitar në kohën e shitblerjes dhe lidhjes së kontratës për shitblerjen e paluajtshmrisë ku paditësi ngastrat që janë përshkruar në kontratë i ka blerë nga i padituri dhe pagesën për të e ka përmbushur në tërësi në tri rata dhe i njëjti nga ajo kohë ka hyrë në posedim dhe i shfrytëzon i pa penguar nga askush.

Dëshmitari [REDAKTUAR] ka deklaruar se paditësi i ka blerë disa paluajtshmëri nga një person i nacionalitetit serb njëra nga to kufizohet me paluajtshmërin e tij dhe se i njëjti ka shtuar se nga koha e shitblerjes së këtyre paluajtshmëriev i padituri është shpërngulur nga fshati dardani dhe në këto ngastra paditësi është futur në posedim dhe i shfrytëzon i pa penguar nga askush por të njëjtat tani për tani ia ka dhanë personave të tretë që ti punojnë me që paditësi nuk jeton në Kosovë.

Gjykata këtyre dëshmimeve ua dha besimin dhe atë në veqanti dëshmitarit [REDAKTUAR] sa i përket faktit se paditësi i ka blerë këto paluajtshmëri dhe i njëjti ka hyrë në posedim në paluajtshmëritë kontestuese pasi që të njëjtit nip e daj dhe ka qenë dëshmitar në kohën e lidhjes së kësaj kontrate.

Sipas ekspertit të gjeodezisë ngastra kadastrale dhe atë konkretisht NK.nr.194, kufizohet në anën veriore me ngastrën 194-3, në anën lindore me rrugë publike, në anën jugore me NK.nr.195, ndërsa në anën perëndimore kufizohet me NK.nr.193.

NK.nr.193 me kultur livadh kufizohet në anën veriore me NK.nr.191-3, në anën lindore me NK.nr.194, në anën jugore me NK.nr.196, në perëndim me rrugën e arave pasuri komunës.

NK.nr.159, kufizohet në anën veriore me NK.nr.160, në anën lindore kufizohet me rrugën e arave në anën jugore me NK.nr.156, dhe në anën perëndimore me NK.nr.158.

NK.nr.158, kufizohet në anën veriore me NK.nr.161, në anën lindore kufizohet me NK.nr.159, në anën jugore me NK.nr.157, dhe në anën perëndimore me NK.nr.157.

NK.nr.983, kufizohet në anën veriore me NK.nr.984, në anën lindore me proçkën pasuri shoqërore, në anën jugore me NK.nr.982 dhe në anën veriperëndimore me rrugën publike pasuri komunale, në këtë ngastre ndodhët edhe shtëpia e vjetër e rrënuar në etazh përdhes me dimensione 3,50m me 9m, si dhe janë të mbjella rreth 20 fidanë, të llojit të ndryshëm

Gjykata pas vlerësimit të provave lidhur me faktet ka vërtetuar se paditësi nga viti 1984 ka hyrë në posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim në paluajtshmëritë kontestuese sipas marrëveshjes-kontratës me shkrim dhe nga ajo kohë i njëjti i në posedim të vazhdueshëm të papenguar nga askush, pra as nga i padituri.

Paditësi sipas bazës juridike të kontratës mbi shitblerjen dhe mbajtjes me mirëbesim në kuptim të nenit 28 par.1,2 lidhur me par.4 të LTHMPJ nr.6/1980, e ka fituar të drejtën e pronësisë në NK.nr.194, 193, 159, 158 dhe 983, në vendin e quajtur Ivkove Njive të regjistruar në fletën poseduese 32 ZK Dardani

Gjykata ka vlerësuar edhe thëniet e përfaqësuesit të përkohshme të paditurit e cila përmes përgjigjes në paditë dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar në fillim kërkesë padinë e paditësit si të paqëndrueshme, sepse nga provat e administruara si nga dëgjimi i dëshmitarëve, dalja e gjykatës në vendin kontestues është vërtetuar se paditësi ka hyrë në posedim të ligjshëm dhe me mirëbesim në paluajtshmërin kontestuese para më shumë se 32 vite pra në vitin 1984 sipas kontratës me shkrim e cila është përmbushur në tërësi siq u vërtetuar edhe em dëgjimin e dëshmitarit [REDACTED]

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës e mbështeti në nen.452.1 të LPK-së andaj paditësi obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 235€ dhe atë për përfaqësues të përkohshëm për një seancë shumë prej 135€, pasi që shpenzimet tjera i ka kryer si dhe për taksë gjyqësore për paditë shumë prej 50 € dhe aktgjykim shumë prej 50€.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ  
C.nr.257/09 dt.07.04.2016

Gjyqtari  
Alban Beqiri



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVES  REPUBLIKA KOSOVA



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
REPLIKA JE PRAVNOSNAŽNA  
THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC